



Derbin e shqiptareve ne Qemal Stafa e kane fituar ata qe luajne per Zvicren. Ne nje ndeshje pa shume histori, ka mjaftuar nje gol i shenuar nga Xherdan Shaqiri ne fillimin e pjeses se dyte per te zhbllokuar rezultatin. Shqiperia e De Biasit ka luajtur nje ndeshje te shemtuar ku ka munguar qartesia ne loje. Terreni i renduar i Qemal Stafes nuk i ka ndihmuar lojtares e dy ekipeve te shprehen. Kuqezinjte kane krijuar disa raste te pastra fale kembenguljes se Roshit dhe Salihit por nuk kane mundur te dergojne topin ne rrjete. Ate qe nuk e kane bere shqiptaret e kane realizuar miqte nga Zvicra. Stadiumi me me teper se 12 mije shqiptare ka heshtur pas goli te shenuar nga Lang ne minuten e 79 per te mbyllur te gjithë historite e ketij takimi. Nje mije tifozet nga Zvicra ne stadium kane nisur festen pasi me kete fitore kane siguruar kualifikimin per ne boterorin e disa muajve me pas ne Brazil. Kur dukej se gjithcka do te mbaronte, Roshi ka fituar nje 11-metersh ne minuten e 87 te cilin nje minute me vone e ka realizuar Hamdi Salihi . Megjithate kaq nuk ka mjaftuar per ti ndryshuar fatet lojes. Shqiperia e De Biasit pasi ka prishur endrren ne Slloveni dhe Islande ka menduar te shemtohet ne Tirane duke u mundur pa pretenduar shume ne fushe. Tifozet ne stadium kane gjetur motiv shqiptaret e Zvicres per tu marre me ta dhe per te lene te qete kuqezinjte e Shqiperise qe ishin ne nje mbremje te shemtuar qe duhet harruar sa me shpejt.